



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 janar 2020
Nr. ref.:RK 1495/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI68/19

Parashtruese

Antigona Gerqari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Senatit të Universitetit të
Prishtinës “Hasan Prishtina” Nr. 677, të 19 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Antigona Gerqari (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (në tekstin e mëtejme: Senati i UP-së), Nr. 677 të 19 marsit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Senatit të UP-së, Nr. 677 të 19 marsit 2019, përkitazi me refuzimin e ankesës së parashtrueses së kërkesës për zgjedhje në thirrjen profesor asistent në Fakultetin e Mjekësisë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 prill 2019, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 26 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 29 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Senatit të UP-së.
8. Më 27 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se më 13 dhjetor 2018, Senati i UP-së kishte njoftuar parashtruesen e kërkesës se për pozitën e mësimdhënësit për lëndët “Dermatovenerologji” dhe “Dermatozat e trashëguara”, në Fakultetin e Mjekësisë ka zgjedhur në thirrjen akademike “Profesor i asociuar”, kandidaten M.F.
10. Parashtruesja e kërkesës ishte njoftuar se mund të ankohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh tek Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Senatit të UP-së nga dita e pranimi të vendimit.

11. Më 2 shkurt 2019, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Senatit të UP-së kishte nxjerrë raport-propozim nr. ref.01/345, për refuzim, si të pabazuar, të ankesës së parashtresës të kërkesës.
12. Më 19 mars 2019, Senati i UP-së me Vendimin Nr. 677, miratoi propozimin e Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të UP-së, për refuzim, si të pabazuar, të ankesës së parashtresës së kërkesës.

Pretendimet e parashtresës së kërkesës

13. Parashtresja e kërkesës pretendon: *"[...] neni 177 i statutit të UP dhe Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin dhe riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP neni 6 nënpika 1.5. thekson si kriter përjashtues moshën në situatat kur kandidati konkurron për herë të parë punësim në UP dhe si e tillë për mua nuk mund të aplikohet".*
14. Parashtresja e kërkesës pretendon se është diskriminuar: *"[...] arsyeja e refuzimit tim sikur të mos ishte arsye fiktive, e paramenduar dhe në instancë të fundit edhe dashakeqe sugjeron që unë si kandidat nuk kam fare arsye me konkuru në konkurset e ardhshme sepse atëherë do të jem edhe më e vjetër [...] vendimi i këtij komisioni aprovohet si veprim definitiv duke pranuar diskriminimin moshor si kriter [...] vetëm në rastin tim kemi zgjedhje të stafit me moshë sa unë dhe më të madhe të botuar në të njëjtin buletin".*
15. Parashtresja e kërkesës i referohet dispozitës së nenit 2 të Ligjit kundër Diskriminimit nr. 2004/3, që përcakton se trajtimi i barabartë nënkupton se nuk duhet të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazë të, mes tjerash, moshës.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtresja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
17. Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

18. Gjykata gjithashtu u referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç parashikohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], që parasheh:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2.Individi mund ta ngrit kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

19. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1)Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

20. Në vlerësimin nëse parashtruesja e kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së saj, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë nga “*autoritetet publike*”, pasi të kenë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kriter është po ashtu i përcaktuar në nenin 47 të Ligjit. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore që i ka në dispozicion sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, dhe në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.
21. Në këtë drejtim, bazuar nga dokumentet e përfshira në kërkesë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar kërkesë në Gjykatë, dhe paraprakisht, nuk ka iniciuar procedurë administrative tek gjykatat e rregullta me qëllim të kontestimit të Vendimit të Senatit të UP-së Nr. 667 të 19 marsit 2019.
22. Sa më sipër, pretendimet e parashtrueses së kërkesës për diskriminim bazuar në moshën e saj janë të parakohshme dhe se Gjykata-në pajtim me parimin e subsidiaritetit- nuk mund t’i vlerësojë këto pretendime pa qenë paraprakisht të ngritura dhe vlerësuara nga gjykatat e rregullta (shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI89/15 Parashtrues *Fatmir Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, paragrafi 35).
23. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesja e kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë kushtetuese. Përndryshe, parashtruesja e kërkesës është përgjegjëse kur rasti i saj shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljet e pretenduara në procedurë të rregullt (shih, Aktvendimi në rastin KI139/12, *Besnik Asllani*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012,

i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; Aktvendimi në rastin nr. KI07/09, *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18; Aktvendim në rastin nr. KI89/15, *Fatmir Koci*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr.473/2014, i 21 nëntorit 2014, paragrafi 35; dhe shih, *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës*, [DHM] § 74; *Kudla kundër Polonisë* [DHM] § 152; *Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë* [aktvendim]).

24. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi i kriterit për shterim, siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është që t'u ofrohet autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive ligjore për shkeljet e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i datës 28 korrik 1999).
25. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka bërë çdo gjë që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej saj në lidhje me shterimin e mjeteve juridike (shih, GJEDNJ, rasti *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 116), apo se ekzistojnë rrethana të veçanta që e lirojnë parashtruesen e kërkesës nga obligimi për shterimin e të gjitha mjeteve juridike (shih rastin Nr. KI116/14, Parashtrues *Fadil Selmanaj*, Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese i 26 janarit 2015, paragrafi 46).
26. Sa më sipër, kërkesa në baza kushtetuese për shkak të mos shterimit të të gjitha mjeteve juridike, duhet të shpallet e papranueshme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

